



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

PA1.nr.978/2020

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS – Departamenti i përgjithshëm, kolegji i përbërë nga gjyqtarët Ferit Osmani, kryetar i kolegjit, Hashim Çollaku dhe Zyhdi Haziri, anëtarë, me bashkëpunëtorin profesional Bujar Ahmeti, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të akuzuarit A.S., nga Fushë Kosova, për shkak të veprës penale uzurpimi i paligjshëm i pronës së pa luajtshme nga neni 332 par.1 të KPK, duke vendosur sipas ankesës së të akuzuarit A.S., të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal, P.nr.5548/2016, të dt.19.02.2020, në seancën e kolegjit të mbajtur me 11.01.2021, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar, ankesa e mbrojtësit së të akuzuarit A.S., kurse aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal, P.nr.5548/2016, të dt.19.02.2020, **vërtetohet**.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e ankimuar të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal, P.nr.5548/2016, të dt.19.02.2020, është shpallur fajtor i akuzuari A.S., për shkak të veprës penale uzurpimi i paligjshëm i pronës së pa luajtshme nga neni 332 par.1 të KPK, dhe i është shqiptuar dënimi me kusht, duke i vërtetuar dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 8(tetë) muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet poqe se i akuzuari në afatin e verifikimit prej 2 (dy) vite nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nuk kryen vepër të re penale.

Dënimi i shqiptuar me kusht, është kushtëzuar me lirin e pronës, ashtu që ndaj të akuzuarit është shqiptuar urdhrin për përmbushjen e detyrimit, dhe atë lirin e pronës së të

dëmtuarit M.S. në sipërfaqe 579 m², me numër 00663-32, zona kadastrale Fushë Kosovë, në afat të përmbushjes 30 (tridhjetë) ditë pasi që ky aktgjykim të bëhet i plotfuqishëm.

Konform nenit 55 lidhur me nenin 51 par.3 të KPK, nëse e akuzuara nuk e përmbush detyrimin e paraparë me nenin 51 par.3 të KPK, të theksuar si më lartë, dënimi me kusht konform nenit 59 par.1 nënpar.1.13 të KPK, do ti revokohet dhe do të ekzekutohet dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 8 (tetë) muajve.

Është obliguar i akuzuari që të paguajë shpenzimet e procedurës penale sado që të jenë ato sipas llogarisë së bërë në arkë të gjykatës, në emër të paushallit gjyqësor të paguajë shumën prej 50 (pesëdhjetë) Euro, në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit të paguajë shumën prej 30 (tridhjetë)Euro, të gjitha këto në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm.

Pala e dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore juridike është udhëzuar në kontest të rregullt juridiko-civil.

Kundër këtij aktgjykimi, në afat ligjor ankesë ka ushtruar i akuzuari A.S., për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe vendimit lidhur me sanksionin penal, duke propozuar që ankesa e ushtruar të aprovohet si e bazuar, ndërsa aktgjykimin i ankimuar të anulohet dhe çështja penale ti kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe vendosje, ose që i njëjti të ndryshohet dhe i akuzuari të lirohet nga akuza.

Prokuroria e Apelit, me shkresën, me shkrim PPA/II.nr.991/2020, datë 16.10.2020, pas vlerësimit të ankesës së ushtruar, aktgjykimit të ankimuar, si dhe shkresave të tjera të lëndës, ka propozuar që ankesa e të akuzuarit A.S., të refuzohet si e pabazuar, ndërsa aktgjykimin i ankimuar të vërtetohet.

Gjykata e Apelit, pasi shqyrtoi shkresat e kësaj çështje juridiko-penale, studioi aktgjykimin e ankimuar sipas ankesës së ushtruar, në kuptim të nenit 394 të KPPK-së, gjeti se:

Ankesa e të akuzuarit A.S., nuk është e bazuar.

Sipas ankesës së të akuzuarit A.S., aktgjykimin i gjykatës së shkallës së parë, është ankimuar për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, të cilat shkelje konsistojnë në atë se gjykata e shkallës së parë me rastin e thirrjes së dëshmitarëve nuk e ka ftuar dëshmitarin – shitësin Z.T., i cili do të dëshmonte se në këtë tokë ka jetuar S.B. para shumë vitesh, por që gjykata e shkallës së parë e hodhi poshtë pa ndonjë arsye. Gjithashtu, aktgjykimin i ankimuar është i përfshirë në shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, pasi që i njëjti bazohet në prova të papranueshme, pasi që me asnjë fakt nuk është vërtetuar se i akuzuari ka uzurpuar pronën e cekur në aktakuzë. Andaj, në prani të këtyre rrethanave i propozojmë kolegjit të kësaj gjykate që

aktgjykimin e ankimuar ta anulojë dhe çështjen penale të ia kthejë gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe vendosje.

Kolegji i kësaj gjykate, e ka shqyrtuar dhe vlerësuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, për të cilat shkelje përkujdeset edhe sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 394 të KPPK, dhe ka ardhur në përfundim, se aktgjykimi nuk përfshihet me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale në kuptim të nenit 384 par.1 pika.1.8 të KPPK për të cilat shkelje pretendohet në ankesën e ushtruar nga ana e të akuzuarit. Kolegji vlerëson se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, përkatësisht dispozitivi i të njëjtit është i kuptueshëm, i qartë dhe në harmoni me vetveten si dhe me arsyetimin, ngase përmban arsyet lidhur me faktet vendimtare përkitazi me veprën penale uzurpimi i paligjshëm i pronës së pa luajtshme nga neni 332 par.1 të KPK, sepse gjykata e shkallës së parë ka vërtetuar elementet konstitutive të veprës penale si dhe figurën e së njëjtës, me procedimin dhe vlerësimin e të gjitha provave nga shkresat e lëndës, sikurse është deklarata e dëshmitarit – të dëmtuarit M.S., si dhe provat materiale sikurse janë kontrata e shitblerjes të paluajtshmërisë me nr.6052 e dt.08.07.2011, aktvendimin e Drejtorisë për Ekonomi dhe Financa nr.31 i dt.08.07.2011, administrimit të koordinatave të parcelave 00663-30, 00663-67, 00663-54 Z.K. Fushë Kosovë, të dt.07.07.2015, nr.05-952-16999/2015, listën poseduese-certifikatën e pronësisë të dt.06.07.2015 dhe kopjen e planit të dt.07.07.2015. Ashtu që nga të gjitha provat e administruara dhe të vlerësuara rezulton se në veprimet e të akuzuarit pasi që janë formuluar elementet inkriminuese të veprës penale e cila i vihet në barrë, gjykata e shkallës së parë drejtë ka vendosur kur të njëjtin e ka shpallur fajtor dhe ia ka shqiptuar dënimin përkatës ligjor sikurse në dispozitiv të aktgjykimit.

Sipas ankesës së të akuzuarit A.S., aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, është ankimuar për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, duke theksuar se në këtë çështje penale gjykata e shkallës së parë ka bërë vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike meqenëse me asnjë provë nuk ka mundur që të vërtetojë se i akuzuari ka uzurpuar pronën dhe shtëpinë në sipërfaqe prej 579m², ashtu që për të vërtetuar këtë është dashur që të bëhet shikimi i terrenit, ku është dashur të dalin përfaqësues të gjykatës dhe të konstatojnë në procesverbal, më pas të vërtetohet saktësisht se sa sipërfaqe dhe se si e njëjta është uzurpuar. Andaj, si pasojë e mos ndërmarrjes së këtyre veprimeve nga ana e gjykatës së shkallës së parë nuk është arritur të vërtetohet në mënyrë të plotë dhe të drejtë gjendja faktike, ashtu që ka ardhur deri tek konstatimi i gabuar se prona e lartë cekur është uzurpuar nga ana e të akuzuarit, prandaj dhe i propozojë kolegjit të kësaj gjykate që aktgjykimin e ankimuar ta anulojë dhe çështjen penale të ia kthejë gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe vendosje, ose që aktgjykimin e ankimuar ta ndryshojë dhe të akuzuarin ta lirojë nga akuza në mungesë të provave.

Kolegji i kësaj gjykate ka vlerësuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, sipas ankesës së të akuzuarit, sa i përket gjendjes faktike, dhe ka ardhur në përfundim se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë ka vendosur kur të akuzuarin e ka shpallur fajtor për shkak të veprës penale uzurpimi i paligjshëm i pronës së pa luajtshme nga neni 332 par.1 të KPK, sepse përmes të gjitha provave të administruara dhe vlerësuara, sikurse janë deklarata e dëshmitarit – të dëmtuarit M.S., si dhe provat materiale sikurse janë kontrata e shitblerjes të paluajtshmërisë me nr.6052 e

dt.08.07.2011, aktvendimin e Drejtorisë për Ekonomi dhe Financa nr.31 i dt.08.07.2011, administrimit të koordinatave të parcelave 00663-30, 00663-67, 00663-54 Z.K. Fushë Kosovë, të dt.07.07.2015, nr.05-952-16999/2015, listën poseduese-certifikatën e pronësisë të dt.06.07.2015 dhe kopjen e planit të dt.07.07.2015. Gjykata e shkallës së parë ka analizuar dhe vlerësuar të gjitha provat veç e veç dhe të gjitha së bashku, duke ardhur në përfundimin se i akuzuari në mënyrë të vazhdueshme nga viti 2011 e ka shfrytëzuar këtë pronë dhe atë pa ndonjë bazë juridike, respektivisht në mënyrë ilegale, çka vërtetohet nga të gjitha provat e administruara se i akuzuari saktësisht e ka ditur se prona të cilën ai e ka shfrytëzuar nuk ka qenë e tija por se ka qenë e Z. T., i cili të njëjtën ia ka shitur të dëmtuarit, fakt që u vërtetuar nga provat materiale të lartë cekura, ashtu që në këtë çështje penale është vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë gjendja faktike.

Sipas ankesës së të akuzuarit A.S., aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është ankimuar për shkak të vendimit për dënimin, duke theksuar se gjykata e shkallës së parë, me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit, nuk i ka analizuar të gjitha rrethanat lehtësuese duke i shqiptuar dënim tejet të lartë dhe jo në proporcion me veprimet që i akuzuari i ka ndërmarr. Sipas ankesës së ushtruar, gjykata e shkallës së parë nuk ka marrë parasysh rrethanat lehtësuese në anën e të akuzuarit, sikurse është fakti se i njëjti ka qenë i sjellshëm dhe ju ka përmbajtur rregullave të procedurës gjyqësore, e gjithashtu edhe të këqijat që pretendohet që i ka shkaktuar poseduesi-shfrytëzuesi i tokës S.B., i cili realisht ka qenë posedues i kësaj patundshmëria që 50 vite, andaj nuk është dashur që ti shqiptohet dënim me burgim.

Kolegji i Gjykatës së Apelit, ka vlerësuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, ankesën e ushtruar, si dhe shkresat e tjera të lëndës, dhe ka ardhur në përfundim se aktgjykimi i ankimuar nuk përfshihet me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljet e ligjit penal, se gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë dhe të plotë ka vërtetuar gjendjen faktike, e cila është vërtetuar nga provat e administruara, e gjithashtu gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar edhe rrethanat lehtësuese, sikurse edhe ato rënduese, ashtu që me rastin e marrjes së vendimit për dënimin, caktimit të llojit dhe lartësisë së tij, ka vlerësuar të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 64 të KPPK (Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës), si rrethana lehtësuese ka vlerësuar se i akuzuari më parë nuk ka qenë i dënuar me aktgjykim të formës së prerë, ndërsa si rrethana rënduese ka vlerësuar mënyrën e kryerjes së veprës penale, si dhe shkallën e intensitetit të kryerjes së të njëjtës, ka vlerësuar edhe mos gatishmërinë e të akuzuarit për të liruar pronën e të dëmtuarit pavarësisht faktit se ka qenë i vetëdijshëm se prona nuk i takon atij, ndërsa nga ankesa e ushtruar nuk ka gjetur ndonjë rrethanë posaçërisht lehtësuese, andaj, në prani të këtyre rrethanave, kolegji është i bindur se me dënimin e shqiptuar do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij, që të parandalojë kryerësit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tyre, të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale, të bëjë kompensimin e viktimave ose të komunitetit për humbjet ose dëmet e shkaktuara nga vepra penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, të paraparë në nenin 34 të KPPK-së (Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës).

Nga sa u tha më lartë, e në bazë të nenit 401 të KPPK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
PA1.nr.978/2020, të datës 11.01.2021

Bashk. profesional,
Bujar Ahmeti

Anëtarët e kolegjit
Hashim Çollaku

Kryetari i kolegjit
Ferit Osmani

Zyhdi Haziri